



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2020:164245  
Datë: 17.05.2024  
Numri i dokumentit: 05702039

**K.Dh.Sh II.nr. 107/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “Malësia Reisen” Sh.p.k., me NRB:71116611, me seli në Prishtinë, rruga “Fehmi Agani” nr.137, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Avokate Apolona Syla nga Prishtina, kundër debitorit “Komuna e Pejës”, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Avokate Drita Sopi – Gashi nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.546/22 të datës 25.10.2023, me datë 16.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit “Komuna e Pejës”, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.546/22 të datës 25.10.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.546/22 të datës 25.10.2023, në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Pejës, ashtu që është anuluar pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.740/20 të datës 29.10.2020 i Përmbartuesit Privat Eset

Murati, për pjesën e detyrimit në shumën prej 4,265.69 €. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Komuna e Pejës”, ashtu që ka lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit Përmbartimor P.nr.740/20 të datës 29.10.2020 i Përmbartuesit Privat Eset Murati, për pjesën e detyrimit në shumën prej 2,194.99 €. Në pikën III të dispozitivit është përfunduar pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “Malësia Reisen”, ndaj debitorit “Komuna e Pejës”, sipas urdhrit P.nr.740/20 të datës 29.10.2020 i Përmbartuesit Privat Eset Murati, për pjesën e detyrimit në shumën prej 4,265.69 €.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.546/22 të datës 25.10.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Malësia Reisen” Sh.p.k, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumenteve të besueshme – Fatura nr. 2522-210-001-19 e datës 23.09.2019, nr.2834-210-001-19 e datës 18.10.2019, nr.30-210-001-20 e datës 10.01.2020, nr.251-210-001-20 e datës 13.02.2020, nr.288-210-001-20 e datës 20.02.2020, nr.301-210-001-20 e datës 24.02.2020, nr.326-210-001-20 e datës 28.02.2020, nr.573-210-001-20 e datës 29.09.2020; ku e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj borxhin total kreditorit në shumë prej 6,460.68 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e arritjes së kërkesës për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ka deklaruar se është paguar me shumë se gjysma e borxhit nga ana e debitorit dhe thekson se procedura ka filluar në kundërshtim me parimin e ndershmërisë dhe ndërgjeshmërisë. Andaj i ka propozuar Gjykatës ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, shfuqizoj urdhrin përmbarimor dhe të anuloj të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ndër të tjera ka kundërshtuar pretendimet e debitorit ngase pagesat e faturave janë kryer pasi që ka filluar procedura përmbarimore, andaj kreditori tërhiqet nga borxhi për pjesën të cilën e ka përmbushur debitori në vlerë prej 4,265.69 €. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar Gjykatës ta refuzoj prapësimin si të pabazuar për pjesën e mbetur të borxhit në vlerë prej 2,194.99 € së bashku me kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.546/22 të datës 25.10.2023, ku në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Pejës, ashtu që është anuluar pjesërisht Urdhri Përmbarimor P.nr.740/20 të datës 29.10.2020 i Përmbaruesit Privat Eset Murati, për pjesën e detyrimit në shumën prej 4,265.69 €. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Komuna e Pejës”, ashtu që ka lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit Përmbarimor P.nr.740/20 të datës 29.10.2020 i Përmbaruesit Privat Eset Murati, për pjesën e detyrimit në shumën prej 2,194.99 €. Në pikën III të dispozitivit është përfunduar pjesërisht procedura përmbarimore e kreditorit “Malësia Reisen”, ndaj debitorit “Komuna e Pejës”, sipas urdhrin P.nr.740/20 të datës 29.10.2020 i Përmbaruesit Privat Eset Murati, për pjesën e detyrimit në shumën prej 4,265.69 €.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbarim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbaruesit Privat Eset Murati është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit në vlerë prej 4,265.69 €, fakt ky që vërtetohet nga transferi bankar i datës 09.11.2020 i cili gjendet në shkresat e lëndës, e cila pagesë është pohuar edhe nga ana e kreditorit. Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke e lënë në fuqi urdhrin e përmbaruesit privat P.nr.740/20 të datës 29.10.2020, për pjesën tjetër të detyrimit në shumën prej

2,194.99 € për faktin se debitori një pjesë të obligimit e ka përmbushur në vlerë prej 4,265.69 €, e cila vërtetohet me njoftimin e debitorit për faturat e lartcekura dhe pranimin e borxhit nga ana e debitorit prandaj rezulton edhe kryerja e pagesës së pjesëshme. Tutje, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit si rrjedhojë e përmbushjes së pjesëshme të kredisë në të holla të palës kreditore, ndërsa urdhrin përmbartimor e lë në fuqi, sa i përket pjesës së mbetur prej 2,194.99 €.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të kujdest dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke shfuqizuar urdhrin përmbartimor për pjesën e borxhit prej 4,265.69€ €, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim nga shkresat e lëndës konstatohet se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbartim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbartuesit Privat Eset Murati është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit në vlerë prej 4,265.69 €, fakt ky që vërtetohet nga transferi bankar i datës 09.11.2020 i cili gjendet në shkresat e lëndës, e cila pagesë është pohuar edhe nga ana e kreditorit. Andaj, fatura në bazë të cilës është lejuar urdhri përmbartimor e ka humbur pjesërisht efektin sepse e njëjta është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit në kuptim të nenit 71 par1 nëpar.1.2 të LPP-së me të cilin parashihet se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se edhe për pikën II të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa ka lejuar urdhrin përmbartimor në shumën prej 2,194.99 € ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, të cilat përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet ankimore lidhur me at se debitori ka paguar më tepër se gjysmën e borxhit dhe se kreditori me incimin e procedurës po krijon shpenzime, por të njëjtat mbesin të pabazuara pasi që nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbartimore.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**  
K.DH.SH.II nr.107/24 me datë 16.05.2024

Gjyqtarja  
Franciska Zhitija- Ymeri